

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29.06.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Burim Gërguri (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Labinot Mirena, (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Armend Rushiti (LB), Nora Preniqi, (LB), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, dhe përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara:
3. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB)-i, 2022-2024
4. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së, për themelimin e Komisionit
5. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, sipas vendimit nr.-I-31, të dt.26.02.2021
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

**Kryesuesi** - I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

**Armend Rushiti** - Unë kam një kërkesë që të futet në rend dite edhe kërkesa që ta kemi procesverbalin e dt.13 prill të Komisionit që e ka bërë ndarjen e banesave për kategoritë e dalura nga lufta edhe pse në bazë të informatave e dijmë se kanë votuar unanimitisht, por me na njoftue. Meqë, nuk ka as shpallje të listës, po insistoj në bazë të informatave që të bëhet vetëm shpallja për kategorië e dëshmorëve veçmas.

**Kryetari** - Ne e dijmë se e kemi një vendim, ku janë 2 kategoritë rastet sociale dhe kategoritë e dalura nga lufta. Ne e kemi formur një Komision qe disa vite dhe në vazhimesi herë ka munguar dikush, e herë dikush, por me rëndësi është se puna nuk është kryer. Qëllimi ka qenë që edhe unë qëndroj prapa saj, që të ketë transparencë, mos të flitet nëpër kafe qysh është duke u folë dhe është mirë që Komisioni ta bëjë zgjedhjen preliminare, zgjedhje përfundimtare nuk ka, por ka procesverbal. Mendoj se Komisioni duhet me i ndjekë procedurat ligjore të cilat janë përndryshe, unë do ta shkarkoj Komisionin nëse, ndodhë e kundërta dhe do të filloj me një Komision të ri. Sa i përket çështjes së listave, lista nuk ka dhe duhet të ketë votim sipas ligjit në fuqi për secilin kandidat veç e veç, duhet me votue me qëllim që pastaj me sjellë raportin në Kuvend për miratim. Komisioni është duke vazhduar punën, por ka forma që duan ta bëjnë politike, prandaj unë ju lus të gjithëve se nuk është mirë me lue me këto kategori dhe nëse ju e vlerësoni mund të jeni pjesë të gjithë edhe anëtarë të Komisionit, ose vëzhgues. Ju që e jepni mendimin, unë jam i gatshëm që kjo të bëhet në mënyrë transparente, me i ftue të gjitha kategoritë e dalura nga lufta dhe bashkarisht ta trajtojnë aplikacion për aplikacion. Komisioni ende nuk e ka kryer punën e vet dhe ne mund ti japim edhe një afat që ata ta kryejnë

punën, ta bëjnë transparente listën, ti thërrasin të gjithë veteranët nëse, është e domosdoshme dhe në prezencën e secilit të shprehin atë që e thojnë, por jo nëpër okulare, kafe, e vende të ndryshme me fjalët më të liga që mundet me i thënë dikush. Mbi të gjitha, për këtë çështje është Komisioni përgjegjës dhe Komisioni duhet me e votue individ për individ, në të kundërtën çfarëdo raporti që vjen për mua është i papranueshëm. Nëse, ju doni me votue është çështje e juaj, por për mua këta duhet me sjellë për secilin individë të votuar për përfitim të banesave. Pastaj, atë raport e sjellim në Kuvend dhe ju e vlerësoni.

**Kryesuesi** – Këto, është dashur të jenë pyetje parlamentare në fund dhe çdo Komision i formuar nga Kuvendi, e ka për obligim me sjellë një raport përfundimtar dhe pa e pasë atë raport ne nuk kemi çka të flasim. Prandaj, nuk mund të përfshihet kjo pikë në rend dite, kur nuk kemi material për shqyrtim, do të thotë nuk e kemi procesverbalin, as raportin.

**Lulzim Sadiku**– Vërtetë, Kryetar ishe bukur i qartë, sinqerisht, nuk po bëjmë politikë dhe me këtë që e the sikur të ishte në rend dite. Unë kisha me i bë 2 pyetje pa asnjë qëllim nëse, lejohet. Sinqerisht nuk është mirë me folë kafeve sepse është çështje shumë madhore që duhet të jetë konfidenciale sepse njerëzit preken. Mirëpo, nëse bë n, ose le të mbetet në pikën “Të ndryshme” sepse ju i dhatë jashtë rendit të ditës përgjegjet që po të ishte në rend dite, sikur nuk do të kishim diçka më shumë për të thënë. Dua, të di se cilat kritere po përfshihen sepse mua më ka interesue, jam pjesë e Kuvendit, kam qenë këmbëngulës, atëherë kanë qenë 3 shoqatat dhe ju e keni lejue. Na keni mbivotue realisht dhe ishte vetëm pozita për ndarje të banesave, opozita nuk kemi mbërri me kalue asnjë. Sa i përket konfliktit të interesit Kryetar te ndarja e banesave, Kryetar i Komisionit z.Ibush Mjekiçi, qysh e përfshin konflikti i interesit psh sepse 2 fshatra janë Mjekiçi, që nëse, merrë banesë një Mjekiçi nga Grabofci, z.Ibush është nga fshati Shipitullë. Unë kërkoj falje, por është mirë të mbetet në pikën “Të ndryshme” e nëse jo e lejmë si pikë qysh do që është, nuk po dyshoj, do të mbetet konfidenciale, vërtetë nëse bën.

**Kryetari** –Sa i përket çështjes së votimit, këta janë 7 anëtarë, që e kanë të drejtën e barabartë dhe në rastet kur paraqitet konflikti i interesit është mirë që ai anëtarë të delë jashtë, e të mbeten 6 që mundën me votue. Mendoj se në këtë drejtim nuk është dashur me pasë problem, pse mos me qenë nëse, është e nevojshme edhe krejtë Kuvendi, krejtë veteranët aty, kur të bëhet ndarja e banesave dhe me bë një përzgjedhje taman të sinqertë. Sigurisht, se nuk kanë me mund me i nda për të gjithë, por edhe ata që kanë me qenë për më vonë me qenë në listë të pritjes. Ne kemi me pasë mundësi me nda edhe banesa tjera, në të ardhmen që me u mundue me zgjidhë problemin. Mendoj se më mirë është me bë zgjedhjen taman ashtu si duhet e me i gëzue banesat, ata që kanë nevojë, ndërsa pjesën tjetër e vazhdojmë.

**Aziz Bici** – Edhe unë e përkrahu propozimin e z.Armend Rushiti, që të futet në rend dite, edhe pse mendoj se ne mundemi me dhënë kontributin sepse kemi qenë në rrjedha dhe është votue Komisioni për vlerësimin se kush do ti merrë, banesat, që ju e dini se unë kam votuar kundër për arsye se qysh atëherë, është vërejtë se mënyra qysh është projektue, ndarja e banesave e dini shumë mirë se është pritë kjo pabesi ndaj këtyre kategorive. Unë po ju them, se nuk keni të drejtë me u thirrë absolut në këto kategori të dalura nga lufta sepse ne sikur për kategoritë e dalura nga lufta jemi bërë objekt loje, i grupeve të interesit, sikur ne jemi pengesë çdokund. Megjithatë, më së shumti këtu përfiton politika e cila nuk i mbron interesat e këtyre kategorive. Arsyeja në atë kohë pse unë kam votuar kundër ka qenë sepse unë kam thënë nuk kemi nevojë për me nda 50 me 50, ne duhet ti ndajmë rastet sociale me prioritet. Kategoritë të cilat janë të dalura nga lufta dhe në rast se vërtetë janë raste sociale, atëherë për pak mundemi me ua dhënë një përparësi të vogël. Mirëpo, qysh në fillim ndarja 50 me 50, mua më len me dyshue se këtu ka interesa të ngushta dhe fakti pse kaq afër zgjedhjeve doli ky fare problemi, pse. Mendoj se sipas ligjit nuk kemi nevojë me votue listën të cilën e ofron Komisioni për vlerësimin për ndarjen e këtyre banesave, pse me votue ne kur nuk kemi qenë pjesë e Komisionit. Ne për këtë e kemi votue Komisionin, që me marrë përgjegjësi ata, edhe ligjore, dhe morale dhe politike, që me punue drejtë me kriter. Për këtë unë po them se këtu, nuk shihet transparencë qysh tha parafolësi im, përkundrazi shohë njëfarë ikje nga përgjegjësia dhe blerje e kohës. Prandaj, po them se ne nuk kemi të drejtë pas kaq viteve, që nëse nuk gaboj në vitin 2018, është votue këtu me shumicë

votash Komisioni për ndarje të banesave, nuk kemi të drejtë aq lehtë me thënë qysh tha Kryetari se në rast se nuk punojnë drejtë kam me anulue atë dhe me shkue me tjetër Komision. Duhet me u marrë në përgjegjësi se pajtohem plotësisht, por ku kemi qenë atëherë kur është votue, pse është votue, pse me humbë gjithë kjo kohë, duhet me marrë përgjegjësi. Prandaj, nëse doni ne këtë pikë të rendit të ditës mund ta lejmë për të ardhmen sepse gjithë këtë punë që e ka bërë ky Komision, kemi informacione jozyrtare që më vjen keq dhe për atë nuk dua të përmendi emra si konfirmim që ka pasë ndarja dhe konflikti i interesit, tash kërkesë e imja është që të na dorëzoni punën e Komisionit vlerësues secilit anëtarë të Kuvendit dhe të caktohet një datë për këtë pikë të rendit të ditës.

**Kryetari** – Unë dua të ia sqaroj z.Aziz, se nëse nuk respektohet e drejta ligjore, unë këtë raport nuk e pranoj dhe ju nëse, e pranoni është çështje e juaj. Unë ligjërisht e marrë përgjegjësinë për çdo veprim timin sepse jam i obliguar me marrë përgjegjësinë, por listë paushalle dhe votë për krejtë listën nuk ka, votë. ka për secilin aplikacion veç e veç. Po ashtu, edhe për dhënien e pronave në shfrytëzim, ne e kemi dhënë propozimin dhe ju e keni votuar secilin veç e veç dhe nuk keni votuar në pako. Tek lista, ndarja 50 me 50, ky ka qenë një vendim i Qeverisë që ne jemi duke e respektuar. Tani, çdo vendim që unë e vërej se nuk ka shkue në procedura e gëzoi të drejtën e shkarkimit të atij Komisioni dhe e propozoj Komisionin e ri. Ju, çfarë liste kërkon me ua sjellë, për cilën listë jeni duke folë z. Armend, dhe a keni qenë me shikue zyrtarisht se a ekziston ajo listë, apo po informoheni nëpër kafe.

**Aziz Bici** – Sa i përket punës së Komisionit për nadrjen e banesave, ata një mbledhje e kanë mbajtur dhe ai procesverbal duhet të dorëzohet, ose thuaj Kryetar se ky Komision nuk ka punuar kurrë kurgjë dhe pse mos me u denue.

**Lulzim Sadiku** – Vërtetë, nganjëherë njeriu bie në lajthitje pse thotë të jetë transparente, por e pata qëllimin se foli jashtë rendit të ditës dhe e zbërthej situatën. Unë Kryetar në mbledhjen e prillit bashkë me këta kolegë kam kërkuar nga Nënkryetari z. Ibush Mjekiqi, çështjen e gurëthyesit, çështjen e banesave dhe ai ka thënë se e kemi procesverbalin në përfundim dhe me dt.30 prill, ju jeni prezentë dhe në procesverbal shkruan. Unë pse e thashë transparent, e thashë sepse foli jashtë rendit të ditës. Unë e kam marrë premtimin që 2 muaj, prej Nënkryetarit, njëkohësisht edhe prej kryesuesit dhe jam pro që të futet në rend dite kërkesa për banesa. Çështja tjetër është zona me interes të veçantë për fshatrat Sibific, Shipitullë, Lajthishtë, Kryetar nuk ke qenë prezentë dhe Nënkryetari më ka premtue se do ta thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme. Po ashtu, më ka premtue kryesuesi se nuk po e futim në rend dite, por po e bëjmë pak më madhore dhe jam pajtuar me qëllimin që ajo zonë të trajtohet vërtetë, ashtu qysh e meriton. Unë kam biseduar me kryesuesin, i cili tha se Kryetari është duke u marrë me Ministrinë përkatëse, tha brenda një jave do të raportoj. Prandaj, Kryetar po them në mënyrën më njerëzore që ta futni në rend dite, ose me thirrë një mbledhje të jashtëzakonshme sepse në ato fshatra kanë fillue edhe manipulime, kanë të drejtë të ndërtojnë. Mirëpo, në Rregullore nuk po ia futi kot, ju keni lejue që aty të ndërtohet, sepse atje nuk është bërë inçizimi. Në planin urbanistik të vitit 2010, neni 5.6, e jepë shumë qartë se atje mund të ndërtojnë deri në 200 metra afër shiritit. Seriozisht qytetarët po bien në lajthitje. Unë kisha me kërkuë që të futet në rend dite, ose me thirrë një mbledhje të jashtëzakonshme sepse është një problem tepër i madh nëpër ato fshatra.

**Kryesuesi** – Unë e kam njoftue edhe Kryetarin, për çështjen e zonës me interes, por ministrin e mjedisit e kemi pasë pothuajse 2 ditë, dhe jemi në fazën e mesme të planit zhvillimor të ri. Ne e kemi pasë ministrin dhe e ka vizitue Haden, Shipitullën dhe Haden e Re. Tash, ne me thirrë mbledhjen e jashtëzakonshme kur ministri erdhi në Obiliq, për herë të parë, i cili vetëm sa e ka filluar detyrën dukej si njëfarë presioni i madh. Mendoj se edhe Qeveria ka me gjetë mirëkuptim që me rishikueatë vendim të mundshëm.

**Aziz Bici** – Sa i përket punës së Komisionit për ndarjen e banesave, neve duhen të na dorëzohen raporti i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura nga komisioni, e në rast se vërehen parregullsi, duhet që të marrin përgjegjësi. Tani, se A do të na sjellni raportin e Komisionit ne Kuvend?

**Kryetari** – Përgjegjet se ne raportin patjetër do ta sjellim sepse ju keni me votue.

**Kryesuesi** – Ne i patëm 2 propozime, z.Armend Rushiti propozoj që të futet në rend dite raporti i Komisionit për ndarjen e banesave për kategoritë e dalura nga lufta dhe z.Lulzim Sadiku, ishte dakord me atë propozim, por të jetë edhe fshati Hade, zona me interes të veçantë.

Tani, e hudhi në votim propozimin e parë për rendin e ditës.

Pas diskutimeve, me 13 vota për miratohet rendi i ditës i cekur më lartë.

#### **Pika 1 e rendit të ditës**

**Mungoi:** Hysni Mjeku dhe Nazmi Gashi me arsye.

#### **Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

#### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën e DEFZH-së, për shqyrtimin e KAB-it, 2022 – 2024.

**Zarife Behluli** – Ju njoftoj se në materialin për KPF, kam bërë disa gabime teknike dhe nuk ka qenë parashikimi për vitet 2023-2024, por në materialin e dytë e keni parashikimet dhe planifikimin për këtë periudhë. Po ashtu, është një ndryshim rritja e buxhetit është 151,017 €, te politikat e reja në Arsim. Planifikimi i buxhetit sipas Qarkores buxhetore të ardhur nga Ministrisa e financave, si grand i përgjithshëm për vitin 2022, është 2 milion e 361,676 €, grandit specifik i Arsimit, që pikërisht këtu është ndryshimi, që është 2 milion e 744,061 €, grandit specifik për shëndetësi 807,703, që në total grandit për vitin 2022 është 5 milion e 913,440 €. Ligji i Obiliqit është 5 milion €, të hyrat vetanake janë 908,730 dhe total si buxhet për vitin 2022 sipas Qarkores së parë buxhetore i kemi 10 milion e 822,170 €. Kjo masë e buxhetit ndahet në 5 kategori ekonomike.

-Të hyrat vetanake sipas Ligjit të Obiliqit, janë 4 milion e 350,000 €,

-Mallra dhe shërbime janë 1 milion e 188,679 €,

-Shpenzime komunale janë 316,675 €,

-Subvencione 850,000 €, dhe

-Shpenzime kapitale janë 5 milion e 116,816 €,

Totali është 11 milion e 822,170 €.

Pastaj drejtoresha i njoftoi të pranishmit me investimet kapitale nëpër të gjitha Drejtoritë komunale.

**Lulzim Sadiku** – Fillimisht, kur i lexova mendova se do ti kryejmë 2 KAB-at, si shpejtë ashtu si po shkojnë punët, por vërtetë për KAB-in, 2022-2024, nuk vërehet asnjë planifikim dhe fatkeqësisht jemi në situatën e njejtë sikur në buxhet. Unë kam qenë ai që edhe në buxhet kam kërkuar që me na ardhë lista e rrugëve, sot jemi anëtarë të Kuvendit dhe nëse, dikush është afër Kryetarit mund ta dijë se cila rrugë shtrohet atje e znj.Samire, përndryshe unë si shëf i grupit dhe një numër i madh i juaji nuk e dijmë se cila rrugë shtrohet sepse na kanë premtue se kanë me shtrure, por nuk e kanë bërë. Vërtetë, është njejtë edhe çështja e KAB-it, kryesisht është një përshkrim i projekteve vit pas viti, do të thotë kjo është bërë shabllon që po na vjen Korniza e njejtë. Tani, me kërkuar pozicionet e projekteve kapitale për 3 vitet e ardhshme në emër të adresave se ku do të kryhen punët, është paradoksale dhe mendoj se është e pamundur sepse ne nuk dijmë se çka po ndodhë në këtë vit dhe çka kryhet në këtë vit nuk e dijmë. Për çështjen e rrugës më ka premtuar edhe Kryetari Gashi, që në buxhet do ti sjellim rrugët me prioritet në mënyrë që anëtarët e Kuvendit, të dijnë se cilat rrugë do të shtrohen në vitin 2021. Komuna edhe për 1 vit nuk ka bërë publikimin e emrave për realizimin e projekteve. Grupi i anëtarëve të PDK-së mendon se ndoshta, tani ka qenë momenti për qasje radikale sa i takon buxhetit. Komuna, duhet ta ndryshoj formulën e ndarjes së buxhetit në 5 kategori, në 5 linja buxhetore, sidomos ndryshimi duhet të ketë në rritje me subvencione dhe mallrat e shërbimet sepse pjesa më e madhe e projekteve kapitale janë krye. Po ashtu, Komuna, as që po arrinë me i shpenzue mjetet nga kjo linjë e kapitaleve dhe për çdo vit ne po bëjmë shumë ankesa sepse Komunës, po i mbetet suficit. Vërtetë, vitin që shkoi ne e dijmë se Komuna e Obiliqit, pa një planifikim të mirë i ka mbetë suficit 1 milion e 800,000 €. Unë nuk po e fajësoj Kryetarin, por drejtorët gjithsesi sepse është dashur të bëhet një planifikim më i mirë, të thirren edhe anëtarët e Kuvendit sepse jemi pjesë e juaj. Është fat i mirë se subvencionet në shumë fusha janë të pamjaftueshme, ka pakënaqësi në sferën e sportit, kulturës, që nuk

mbështeten mjaftueshëm. Po ashtu, edhe në bujqësi me një harmoni dhe politikë ndryshe të subvencionet mund të krijohen edhe vende pune. Unë isha në një trajnim ku një Komunë në vitin 2021, në Kosovë i ndanë subvencionet ku sasia e krerëve është 300-400 lopë dhe njëkohësisht punëson punëtorë të Komunës 10-15, do të thotë se është gjetë forma që subvencionet të ndahen edhe në këtë kategori. Në një mënyrë kjo është lobim i hershëm dhe vërtetë, nuk dua me ndryshue qasjen, por du me ofruë opcion sepse një projekt i tillë i arsyetuar mirë do të ketë punësime për qytetarët deri në 50 vetë. Nëse, vërtetë subvencionet për shkak të mundësive që marrin operatorët, familjarët pajtohem, por operatorët janë të mëdhenj dhe ka mundësi që të iu japin subvencione dhe ata mund të punësojnë dhe të ofrojnë mundësi tepër të mira.

**Aziz Bici** – Unë po mundohem vetëm të mos i përsërisë shumat milionëshe që janë të planifikuara për vitin 2022, 2023 dhe 2024, por do të flas në të përgjithshmen sepse tani më e dijmë se si bëhet ndarja e buxhetit për sektorë, por edhe si e menaxhoni atë. Subvencione dhe grande për bujqësi dhe blegtori, por pa bujqësi dhe blegtori të zhvilluar, për infrastrukturë rrugore, por pa cilësi dhe rrugë të ngushta që vetëm e vështirësojnë lëvizjen e sidomos me automjete dhe krejtë kjo bëhet për shkak se nuk i përfillni rregullat e Prokurimit, por ndarjen e tenderëve e bëni sipas interesit që e kenë, e si rrjedhojë këtu nuk mund të flitet për cilësi dhe zhvillim në punë, por vetëm për përfitime dhe punësime.

Diçka pozitive është se tani më pak se 4 muaj, ju do të ndaheni nga zyret lokale dhe jam i sigurtë se qytetari i Komunës, do të ju ndëshkojë duke mos iu dhënë rastin me qeverisë më me Komunë.

**Dragan Dancetovic** – Mislím da je ova jos jedna dobra prilika da pokazemo na problema nasih gradjana. Ja bih se i sada zalozio za sve nerazvijene sredine, bile da su selske ili gradske sredinerade da se razvijú, i pre svega mislim da treba uraditi sve ulice da bih nasi gradjani mogubezbedno i na kompletan nacin da koriste nase ulice, jer imamo dosta ulice koje nisu adekvatne. Sa druge strane nesto svakako vazna vest je snabdevanje nasih gradjana sa kvalitetnom tecom vodom, jer mislim da u ovom trenutku je najvazna stvar u kom pravcu treba da radi ova opstinska administracija, i mislim da bihtada elementarnih uslova za zivot i rad nasih gradjana biti ispunjena.

**Shaip Paloja** – Ne e kemi provuar edhe në të kaluarën me projekte të viteve të kaluara dhe mendoj se edhe në këtë vit nuk kemi arsye me dyshue se nuk do të ketë një buxhet të mirë dhe të shpenzuar maksimalisht. Ne e dijmë Kryetar, se në të kaluarën na është kërkuar si anëtarë të Kuvendit komunal, të sjellim projekte dhe të gjitha ato projekte që i kemi sjellë, ndoshta jo njëqind për qind, por 90 %, janë realizue. Faktikisht, edhe kur është fjala te infrastruktura, edhe te rrugët, dhe të gjitha ato që ne i kemi sjellë janë votue, kanë kalue dhe janë realizue. Si qëllim i kësaj është se Komuna jonë është dalë në vendin e dytë të transparencës dhe aspak nuk dyshohet. Po ashtu, është investue edhe në Arsim, rruga e nxënësve, është investue, ndërtimi i sallave sportive, fusha të sportit si dhe pagesa e rrugëtimit të nxënësve dhe një numër i bursave për nxënës dhe studentë. Në kohën e fundit shihet edhe investimi në sheshin e Obiliqit, që ndoshta, është një fakt historic për Obiliqin, se dikush vetëm ka mund me pa në ëndërr se çka ka me ndodhë. Rrënimi i atyre objekteve, faktikisht që ne i kemi quajtur pothuajse varreza që e kanë shëmtuar qytetin e Obiliqit, jemi dëshmitarë se Obiliqi po ndryshon me të madhe dhe investimet janë shumë të qëlluara. Unë e falenderoj edhe njëherë Kryetarin e Komunës, për ditën e çlirimit që ka ndodhë në territorin e Komunës së Obiliqit dhe e falenderoj DKRS-në, për një organizim për ditën e çlirimit, që nuk ka ndodhë deri më tani në Obiliq. Vërtetë, mendoj se është bërë punë e mirë dhe i falenderoj, jemi të gjithë ata që kanë kontribue vite, me vite për Obiliqin dhe Republikën e Kosovës.

**Kryesuesi** – Ju e dini se 2 vitet e fundit kanë qenë vite pandemie, që e falenderoj Kryetarin dhe DEFZH-në, për saktësinë dhe korrigjimin e treguar me kohë. Vit pandemik dhe me arritë me i planifikue të hyrat vetanake dhe me i nxjerrë të gjitha ato borxhe që i kemi falë dhe i kemi lirue, kjo është kogja një tendencë. Në vitin e kaluar është planifikuar buxhet 11,190,796 €, ndërsa në këtë vit me Kornizë vjen 11,822,170 €, ë afër 700,000 €, është një vlerësim më i lartë. Po ashtu, është hera e parë që na vjen buxhetimi gjinor që është një respekt sa i përket respektimit të ligjit 50 %, në administratë.

**Kryetari** – Ne e kemi dorëzue buxhetin dhe çdo rekomandim tuajin ne jemi të gatshëm me diskutue se cila është mundësia. Kjo është Korniza e parë buxhetore dhe në planifikimin e dytë mund ti detalizojmë më

shumë çështjesh nëse, ka nevojë ndonjë ndryshim. Sa i përket zhvillimit të aktiviteteve, ne jemi duke bërë të pamundshme të planifikohet, por të shpenzohet aty ku duhet. Ne jemi mundue me qenë kooperativ vazhdimisht me juve në planifikimet buxhetore, por edhe në planifikimin e projekteve dhe si rezultat i kësaj jemi në mesin e 3 Komunave, që janë shpallë për shpenzimin e grandit. Kjo na ka krijuar mundësinë që ne të përfitojmë edhe mjete buxhetore, që në këtë rast është një vlerë prej 372,000 €, që janë 2 projekte me bashkëfinancim si zgjerimi i gjelbërimit në hyrjen e Obiliqit, që është në proces dhe ndërtimi i trotuarit bashkë me ndriçim nga Kosova B, deri në Plemetin. Në vitet e ardhshme mendojmë me vazhdue deri te parku i gjelbërt me stazën e biçikletave dhe gjelbërimit si dhe njëjtë me vazhdue me infrastrukturë qysh e kemi planifikue. Sinqerisht jam i lumtur se kemi ndërtue ura, shkolla, Shtëpi të shëndetit, parqe dhe shumë e shumë projekte tjera. Atë që e tha më heret i nderuari deputet ne i presim zgjedhjet dhe besoj se qytetarët do ta japin vlerësimin për punën që e kemi bërë. Sido që të jetë ne jemi duke punuar dhe do të vazhdojmë të punojmë njëjtë si në fillim të mandatit.

**Zarife Behluli** – Sa i përket emërtimit të rrugëve, kur të bëhet Qarkorja e dytë buxhetore caktohen rrugët bashkarisht me Kuvendin, me Ekzekutivin dhe kjo e di që ka ndodhë vit pas viti. Në Kornizën e parë buxhetore kryesuesi ka mbajtur takim me anëtarë të Kuvendit dhe nuk di se kush ka marrë pjesë sepse unë kam qenë në Ministri me i zgjidhë disa telashe që i kemi rreth punës. Te rritja e mallrave, mallrat i kam rritë edhe pse në Qarkore thotë mallrat e shërbimet dhe shpenzimet komunale janë në vazhdimësi qysh kanë qenë në vitin 2021, dhe do ta provojmë këtë se a na lejojnë me Qarkoren e dytë, apo jo. Subvencionet 830,000 €, i kemi rritë edhe për 20,000 €, për vitin 2022, edhe kjo është diskutabile se a na lejohet apo nuk na lejohet. Sa i përket rrugëve të ngushta, unë nuk kam përgjegje për këtë sepse janë procedurat e Prokurimit dhe Komisioni me menaxherët e projekteve. Ndërsa, z.Dragan Dancetovic, nuk mbërrijta me kuptue çka tha derisa e mora përkthimin.

**Aziz Bici** – Për rrugën e ngushtë e kam fjalën te rr."Halit Bici" në fshatin Mazgit, afër shtëpisë së Lutfi Durmishit, njëri nga aktivistët e juve, i cili e ka dhënë një kontribut në këtë segment të rrugës. Edhe në një nga mbledhjet e kaluara, kur ka filluar ri-ndërtimi i kësaj rruge, pata thënë se ajo rrugë ka qenë mirë e shtruar, e ka pasë kanalizimin, e ka pasë ujin dhe aty është një kthesë vetëm 3 metra. Pas ri-ndërtimit të kësaj rruge, lëvizja vetëm sa është vërshtirësuar, e sidomos në atë kthesë e cila përafërsisht 45-47 shkallë e ku rruga është shumë e ngushtë. Ju mund t'a shkoni edhe t'a masni atë rrugë dhe do të dalë kështu... thjesht, këtu është çështje interesash, ku ju aktivistëve të juaj u përmbushni kërkesat e tyre personale, e ku nga ana tjetër vështirësohet lëvizja e qytetarëve, e kjo nuk është në rregull. Sa i përket subvencioneve dhe grandeve, unë disa herë së paku kam kërkuar një raport nga një Komision që e formoni ju vetë se cka u bë me ato subvencione, cka u bë me ato grande, dhe unë dua ta shohë rezultatin e tyre, por asnjëherë për asnjërin nuk e keni sjellë.

**Kryetari** – Mendoj se rrugët nuk shtrohen për aktivistë, por për qytetarë dhe unë e falenderoj ata që na mbështetin. Mirëpo, te çështja e pronave, ne gjithëherë i kemi lutë me vullnet të mirë për me bë një gjë të tillë dhe tani asnjë rrugë nuk shtrohet nëse, nuk i plotëson kërkesat e banorëve që i mbledhin nënshkrimet për këtë çështje. Tek subvencionet, nuk e di a e dini se Komuna jonë është e vetmja Komunë, që i subvencionon bujqit edhe me qumësht dhe ne konsiderojmë se përmes atyre mjeteve disa fermerë përfitojnë dhe kanë mundësi të rritjes së numrit të punëtorëve, apo heqjen e shpenzimeve të atyre, që janë duke punuar. Sa i përket subvencioneve, nuk ka Komunë më e fuqishme aktualisht në ndarjen e subvencioneve, që i kemi 836,000 €, që Komunitat tjera me numër të banorëve, janë shumë më të mëdha dhe subvencionet e tyre nuk i kalojnë mbi 100,000 €. Subvencionimin e Arsimit e kemi diskutue disa herë dhe me Rregullore të cilën ju e keni aprovue, edhe tek bursat dhe transporti dhe ne vetëm po e implementojmë atë Rregullore. Të gjithë ata që ua ka mundësue Rregullorja janë përfitues, 70 nxënës përfitojnë bursa, 8 i kemi me master dhe i kemi 2 doktoratura, që të gjitha kanë qenë transparente, të gjitha janë trajtuar nëpër Komisione dhe asnjëherë nuk ka pasë kufizim për dikend pse i përket këtij, apo atij. Mbi 1,147 është numri që janë nxënës, studentë, pastaj studime postdiplomike, të cilët janë përfitues që Rregullorja ua ka mundësue, që as kryeqyteti nuk i ka aq, ndërsa ne jemi Komunë me 21,000 banorë. Sa i përket çështjes së bujqësisë jemi e vetmja Komunë që i kemi pague vet m d met që janë shkaktue dhe vetëm në vitin e kaluar janë dikund rreth 500,000 €, që i kemi subvencionue me mjete të Covid-it, kur e kemi ndarë një pjesë për fermerët. Te sporti, të gjithë ata që kanë aplikue ato mjete që ua kemi ndarë me Kuvend, ato edhe ua kemi dhënë. Te subvencionet tjera, shëndetësia, krejtë janë prej subvencioneve, do të thotë ndajmë ngai 100 €, sado pak me iu ndihmue të prekurve me covid, 300 €, familjeve dhe unë nuk e di çka ka të paqartë për vendimin që ju e keni nxjerrë.

**Aziz Bici** – Nuk patët nevojë me u zgjerue kaq shumë Kryetar. Unë po them një raport nga një Komisioni, cka u bë me subvencionet që janë dhënë për këtë vit, e jo me dalë pas 1 viti, ose pas 2 viteve dhe cili është

rezultati i atyre subvencioneve me grande. Kjo është kërkesa ime dhe ju nuk po na jepni përgjigje. Këtë raport asnjëherë nuk e keni dorëzue, i keni shpallë listat se kush janë përfitues të subvencioneve me grande, por ne duam ta dijmë se cka u bë me subvencione dhe grande.

**Kryetari** – Përgjegjet se asnjë subvencion nuk ndahet pa Komision dhe ne nuk e kemi obligim ligjor me ua sjellë juve raportet. Komisionet i nxjerrin vlerësimet, i bëjnë publikimet dhe çdo ankesë shkon në Komisionin për ankesa dhe normal që trajtohen. Po thoni diçka u zgjerove, por ju kërkuat sqarim dhe unë dhashë sqarim.

**Aziz Bici**– Na jepni përgjegje.

**Kryetari** – Cilën përgjegje, me të sjellë raport, me krijue Komision mbi Komision, apo qysh je duke thënë.

**Aziz Bici** – Jo, Komision mbi Komision, por me formue një Komision dhe ato subvencione që janë ndarë për vitin 2019, me dalë me i shikue nëse, janë dhënë sera a janë duke i punue, apo jo. Në rast se janë dhënë grande tjera, me ditë se qka u bë me ato grande, nëse, janë dhënë psh edhe bletë, me shkue me i vizitue se a i kanë, apo nuk i kanë. Këtë raport e kërkojmë.

**Kryetari** – Ne vazhdimisht i bëjmë këto gjëra, Komisionet janë ato që i shpërndajnë dhe Komisionet janë ato që i mbikqyrin. Ju kur të doni mund të vini dhe ti shihni ato raporte.

**Lulzim Sadiku** – Kryetar, po them thuaju drejtorëve, këshilltarëve dhe atyre që iu ke ndihmuar më ka premtue Luli, se në mbledhje të Kuvendit tash e tutje kemi me u zgjerue dhe me iu ndihmue të gjithëve sepse është e vërtetë, se janë dhënë subvencione, ngapak edhe janë keqpërdorë. Ne e dijmë se dikush i ka marrë 4,700 €, që unë e di dhe që nga dita e nesërme kam me ti përmendë nëse, është nevoja. Prandaj, për çdo Komision kur ka vërejtje unë jam për me tejkalue prej 70-80 % me qenë në rregullë edhe unë pajtohem sepse njëqind për qind është e pamundur. Pyetja ime ishte te rrugët në vitin 2014, 2015, më kujtohet se e keni sjellë se cilat rrugë do të shtrohen dhe ne kemi pasë njohuri. Mirëpo, tash ne nuk kemi më aspak njohuri se cilat rrugë do të shtrohen në vitin 2021.

**Bejtullah Mjekiqi** – I përgjegjem z.Lulzim Sadiku, se është e vërtetë se blegtoria është një sektor që nuk përkrahet, jo vetëm prej Komune, as prej Ministrisë. Ministria në 2 vitet e fundit e përkrahë, por jo sa duhet dhe është një sektor që është mirë me u përcjellë. Sa i përket kontrollës, ne çdo vit, çdo pajisje që e japim e kontrollojmë. Është raporti i Komisionit i cili çdo serë, çdo kultivatorë dhe pajisjet tjera, mos ti përmendi i kontrollon se a janë në shtëpi dhe a janë në përdorim. Nuk ka serë, as pajisje në Komunën tonë që është shitë apo është, keqpërdorë. Unë mund të them për sektorin e blegtorisë, se jemi Komuna e vetme që e përkrahim me vaksinim, me mbarësim, me subvencionim të qumështit, për të gjithë ata që e dorëzojnë në qumështore. Ju informoj se në vitin 2014, kemi fillue me 630 krerë lopë, ndërsa sot në Komunën tonë janë mbi 1,500 krerë lopë. Ne vetëm këtë vit i kemi mbi 3 ferma të reja mbi 5 krerë lopë. Po ashtu, nga 730 dele, sot janë mbi 1,200 dele. Ajo që është më kryesore nuk kemi ngordhje as të deleve, as të bagëtive. Ju si anëtarë të Kuvendit mund të vini dhe të shihni çdo raport, çdo gjë që ju intereson. Këtu, u përmendë shifra 4,700 por z.Lulzim Sadiku po të ishte dalë në terren në Baimoc, dhe ti shohësh 4 ha, 5 ha krejtë përtoke, besoj se atyre nuk kemi mund me ua pague as qiranë, që shumica e kanë tokën me qira dhe shpenzimet. Ne jemi duke bërë përpjekje me Ministrinë e bujqësisë, që atyre të iu paguhet shumë shpejtë dëmi.

**Aziz Bici** – Sot morëm shifra nga drejtori, por ne nuk kemi marrë asnjëherë me shkrim dhe ne nuk kemi të drejtë, as nuk i dijmë adresat se ku i kanë dhënë këtë numër që është në rritje i lopëve prej 700 në 1,500 lopë. Ne sikur ti kishim adresat që sado pak ti shohim shtallat, ne nuk kemi të drejtë me shkue me i vizitue, ndërsa ju si Komunë, si Ekzekutiv keni të drejtë, edhe si Drejtori, ose si Komision. Ne kurgjë më tepër nuk po dojmë sepse kemi ankesa nga qytetarët, kemi ankesa se i jepet dikujt që nuk e meriton dhe nuk i jepet atij që e meriton. Tash, për fat të keq emra nuk po kemi, por së paku që ju me dalë më të arsyeshëm para neve, na jepni adresat e këtyre fermave se ku gjenden dhe ne dalim nëpër terren sepse ju e dini se unë nuk pritoj. Ashtu si i kam vizituar shkollat, shkoj dhe i vizitoj dhe aty ka mundësi së paku që vërtetë të dijmë se paraja publike po shpërndahet dhe të dijmë se po zhvillohet blegtoria, po zhvillohet bujqësia. Ne po e shohim se qka është duke u bërë me tokat pjellore, shpejtë kalojnë vitet dhe këtu, duhet me mbetë se qka po bëhet

këtu. Për këtë po them mos e mermi aq lehtë se pretendimet tuaja që keni qenë në vizita nuk janë shumë bindëse. **Kryesuesi**– Sqaron se kur vjen raporti 6 mujor, ose 1 vjeçar nga Kryetari, aty do ti keni të gjitha.

**Lulzim Sadiku** – Unë e di një numër të madh të këtyre fermave dhe e di gjendjen reale në mënyrë të thukët në bujqësi, pjesërisht sepse i keni nëndegët, i keni ata që ju kanë ndihmuar. Unë i di me emra e mbiemra, në mënyrë të njerëzore se kush i ka shitë serat e tjera, e tjera dhe unë nuk flas fjalë në qiell sepse nuk është në etikën time. Sinqerisht dhe miqësisht po ju them se nëse, nuk delë që nuk e ka shitë se unë i thashë Kryetarit me ua ngrënë veshët drejtorëve dhe njerëzve që i ka afër, mos me keqpërdorë në një mënyrë sepse nëse, edhe ky lejon, atëherë çfarë presin qytetarët. Unë di se njeriu në Komunë i ka marrë 4,700 €, në familjen e tij, nuk përmenda emra dhe unë di emra që mund ti japë, jo një, por dhjetë. Unë nuk flas për inati, por ngjarje të vërteta.

**Kryetari** – Këtu, u tha me ua sjellë emrat për fermat se ku janë, po ka ankesa dhe unë nuk e di se nga po vijnë ato ankesa, tregoni ju nëse vijnë ankesa të tilla nga po vijnë. Është mirë që të gjithë keqbërësit, të gjithë ata që kanë bërë shkelje, sinqerisht me i trajtue.

**Aziz Bici** – Është turp, po lavdëroheni për shkak të punësimeve, del z. Shapi Paloja dhe flet këtu.

**Kryetari** – Turp çfarë sjellje ke në Kuvend, këtu, ka rend dhe është institucion z. Aziz Bici, rebelizmi është kryer. Ju lutem, pa e marrë fjalën mos folni. Çdo kërkesë, apo ankesë që e ke për me ditë se ku janë fermat, eja ta japim ne, ndërsa çdonjëri që flet kafeve atje dhe me fjalë të kafeve vjen këtu, pa e marrë fjalën edhe kjo është e paqëndrueshme. Atëherë çka don me prit prej dikujt tjetër kur ti nuk e respekton institucionin.

**Aziz Bici** – Ato fjalë që i the për mua, ato fjalë janë edhe më të rënda dhe më të këqija, janë tuat, ti keni kaluar nëpër ato, ti je ai i dyshimti. Unë krenohem me të kaluarën time Kryetar, mos harro. Unë nuk bëjë pjesë te njerëzve të korruptuar, unë nuk bëjë pjesë te njerëzit që përfitojnë në situata të ndryshme, unë nuk jam ai mashtruesi që e shfrytëzon edhe situatën e luftës qysh je ti. Asnjë përgjegje nuk ua ke dhënë qytetarëve dhe sigurisht se në të ardhmen do të takohemi nëpër debate dhe do ti themi të vërtetat. Unë nuk i dua milionat prej qytetarë ve. Prapë, po them na i jepni emrat sepse nuk ka dalë rastësisht z. Shaip Paloja në grupin e iniciativës që tash e keni formue.

**Shaip Paloja** – Vërtetë, jam i befasuar me z. Aziz Bici, sepse e kam pasë edhe shok të klasës dhe vërtetë, e vlerësoj të kaluarën e z. Aziz, mirë, ndërsa për politikë po të tregoj drejtë se je shumë prapa. Unë fola me gjithë ato që qytetari shehë dhe e ka prekë për projekte, për ndërtimin e sheshit të qytetit, për infrastrukturën, për Arsim, investimet, subvencionet në bujqësi e gjithkund. Unë thashë gjithçka çka qytetari e ka prekë. Sa i përket ndryshimeve, politike, unë e kam një pyetje z. Aziz, e di që edhe ti 3, ose 4, parti i ke ndërrue dhe unë kam kalue në Aleancë, tash në iniciativë dhe do të jetë përgjithmonë iniciativë.

Mendoj se qytetari i Obiliqit, e ka provue se ku është e mira dhe do ta votoj të mirën përgjithmonë dhe e mira është me z. Xhafer Gashi.

**Aziz Bici** – Z. Shaip, unë kudo që kam qenë, kam dalë i suksesshëm dhe kam dale faqebardhë. Unë kam dhënë dhe nuk kam marrë asnjëherë. Është e vërtetë që sheshi është ndërtue, por sheshi është ndërtue me kaq vonesë. Mundeni me u arsytue se ka fillue pandemia, por ju e dini se një kohë deri në 5 javë ditë punë me dorë nuk është prekë. Sa i përket cilësisë së punës, ju e keni parë dhe ende janë duke i korrigjuar gabimet e veta. Vërtetë, natën me pa është njëfarë bukurie. Vërtetë, Obiliqi ka pasë nevojë për shesh, por nuk ka pasë nevojë për kohë kaq të stërzgjatur deri sa të ndërtohet ky shesh, që ka ndikuar në vështirësim të qytetarëve për lëvizje dhe cilësi të dobët të ndërtimit. Kjo ka ndodhur kështu për shkak të mungesës së konkurrencës dhe zbatimit të rregullave të prokurimit.

**Kryetari**– Z. Aziz, e merrë fjalën rend e pa rend dhe u bë këtu, veç Aziz, por mbi të gjitha të korruptuarit e kanë vendin në burg z. Aziz. Për të gjithë ata që konsideroni se keni dëshmi dhe nuk janë në rregullë, unë gjithmonë kam thënë adresoni, por sjelljet e tua, veprimet e tua nuk po më pëlqejnë, por mbi të gjitha është e drejtë e jotja.

**Aziz Bici** – Prapë Kryetar po të them se është mirë me i kursye fjalët të cilat je duke i përdorë sepse ti në këtë mënyrë nuk e meriton as që të quhesh “kryetar” në momentin që i drejtohesh një asambleisti me fjalën “rebel”. Përkundrazi, unë e mbroj interesin e qytetarit dhe ti këtë e din shumë mirë. Unë asnjëherë nuk e kam rrezikue interesin e qytetarit. Unë i kam kontribue kësaj shoqërie e nuk marrë prej kësaj shoqërie,



ndërsa ti je mashtrues që ke shfrytëzuar të gjitha situatat dhe i ke përdorur të gjitha këto, gjatë luftës e pas luftës.

**Kryetari** – Të njejtën gjë po e bëjmë edhe ne.

**Kryesuesi** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, tani e hudhi në votim KAB-in, 2022- 2024.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për e aprovuan Vendimin për KAB-in, Kornizen Afatmesme Buxhetore (2022-2024).**

**Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesi**– Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DKA-së, për themelimin e Komisionit.

**Lulzim Sadiku** - Unë jam pro formimit të Komisionit, por jam kundër zgjedhjes së 2 zëvendës drejtorëve që janë zgjedhë për shkollë.

**Kryesuesi** – Ju lutem vetëm për pikën e rendit të ditës mund të flisni.

**Lulzim Sadiku** - Unë vërtetë, jam për me ndryshue përbërjen e Komisionit dhe znj.Shyhrete Gashi, e di se është eksperte e Arsimit, por më duket se znj.Fatime Pllana, po bie në lajthitje sepse është pjesë e Arsimit, është pjesë e Komunës. Kërkoj të ndryshohet emri i znj.Fatime Pllana, dhe të mos jetë ajo anëtare e Komisionit.

**Aziz Bici** – Shihet se këta, anëtarë të Komisionit që janë të propozuar janë të kontrolluar prej Kryetarit, prandaj ne nuk do ta votojmë këtë Komision.

**Lulzim Sadiku** – Propozoj z.Agim Preniqi, për anëtar të Komisionit, është pjesë e Arsimit dhe është ekspertë i administratës. Propozimi im është të jenë anëtarë të Komisionit znj.Shyhrete Gashi dhe z.Agim Preniqi.

**Rexhep Zeka**– Unë dua ti japë përgjegje z.Lulzim Sadiku, sepse anëtari i Komisionit duhet të ketë një përgatitje profesionale më të lartë dhe kusht e kemi që një anëtar i Komisionit, duhet të jetë përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit. Fatime Pllana e ka përgatitjen profesionale, por ju njoftoj se në Prishtinë aty ku është shkelë Udhëzimi Administrativ konkurset janë kthyer në pikën 0. Për këtë arsye nuk ka mundësi ndryshimi në përbërjen e Komisionit.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për, 5 vota kundër dhe 1 votë abstenim e aprovuan Vendimin Formohet Komisioni për zgjedhjen e 4 drejtorëve, prej tyre 3 në shkolla fillore të mesme të ulta dhe 1 në institucionin për parashkollor sipas Udhëzimit Administrativ të MASHI-t, Nr.151/2020 për SHFMU:”Migjeni” në Siboc, pozita: drejtor, ”Abdurrahman Gërguri” në Dardhishtë, pozita: drejtor, ”Fazli Grajqevci” në Hade, pozita: drejtor dhe IP ”Rrita jonë” në Obiliq, pozita: drejtor.**

**Komisioni formohet me këtë përbërje:**

1. Fatime Pllana, Kryetare
2. Shyhrete Gashi, anëtare
3. Anëtari i 3 caktohet nga MASHI

**Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqet shqyrtimin e Raportit të DKA-së, sipas vendimit nr.-I-31, të dt.26.02.2021.

**Lulzim Sadiku** – Sa i përket raportit, unë jam pjesë e Arsimit, që e njohë dhe kisha dashur që gjithmonë raporti të jetë i thukët dhe në Arsimit të mos ketë politizim. Unë asnjëherë nuk i kam kundërshtue ato edhe pse kanë qenë pjesë e Aleancës, sepse sepse nëse, janë zgjedhë drejtorët kanë qenë meritator, sepse Obiliqi është pjesë e vogël dhe mësimdhënësit intelektual mund të jenë pjesë e një subjekti politik dhe është problem me gjetë njeriu pa politikë. Te zgjedhja e drejtorëve, asnjëherë nuk e kam kundërshtue zgjedhjen edhe pse znj.Shyhrete Gashi, ka qenë e AAK-së. Vërtetë, është një drejtoreshë që meriton privilegjë dhe për rmuua notohet me noën 10. Unë nuk e kam kundërshtue edhe zgjedhjen e drejtoreshës në gjimnaz sepse me profilin e Arsimit dhe me cilësinë ka qenë ndër më të mirët. Unë jam kundër atyre që nuk kanë përvojë dhe zgjedhen Zëvendës drejtorë për me krye një detyrë. Sinqerisht dhe miqësisht Arsimi, është pjesë thelbësore dhe kryesore e çdo shteti, prandaj nuk bëjmë politikë, por duhet të zgjedhen njerëzit meritator.Ne kemi

problem në të kaluarë në me një numër të nxënësve. Është e vërtetë se Kryetari, Kuvendi, bashkarisht kanë gjetë modul dhe kanë dhënë mundësi me marrë secili nxënës të hyra, që të jetë pjesë e Komunës tonë. Unë mendoj se zgjedhja e zëvendës drejtorëve ka qenë politike, e panevojshme sepse iu ka munguar përvoja arsimore për atë pjesë të menaxhimit të shkollës. Ne e dimë se kemi dhënë bursa edhe për doktorata, edhe për magjistratura, për nxënës dhe profile teknike e tjera. Vërtetë, nëse është nevoja është mirë që këtyre ditëve që hapet konkursi të shikohet gjendja, nëse është e nevojshme të formohet një Komision, që me i mbikqyrë nxënësit në Obiliq, profilet që i kemi me qenë pjesë e përbashkët. Ne duhet ti lejmë politikën në Arsim, sepse vërtetë ka ngapak politikë, por mbi të gjitha edhe nëse, ka politikë të jetë i qëlluar profili në Arsim. Unë nuk dua të hyj në çështje se nëpër shkolla nuk po hapen konkurse adekuate dhe ne thirrmi gjithmonë në kuadër të profilit teknik, kuadrot po mungojnë. Besoni, me shkuje me i pa kur përfundon procesi i grumbullimit të dokumentacionit në shkollën teknike, mbetet klasa me 3, ose 5 nxënës. Ne duhet **Aziz Bici** - Raportin të cilin e ka dorëzue DKA-ja, për përzgjedhjen e drejtorëve, zëvendës drejtorëve, unë personalisht nuk i njohë të gjithë dhe nuk i japi vetes të drejtë për me folë për të gjithë sepse nuk kam fakte. Mirëpo, të bazuar në përzgjedhjen e një zëvendës drejtori z. Ali Nimani, që është vlerësuar me 81 pikë si zëvendës drejtor në shkollën Ibrahim Rugova, unë dyshoj se përzgjedhja është bërë politike edhe te të tjerët. Arsyeja është se për këtë zëvendës drejtor nuk ka qenë bashkëpunimi me mënyrën si asambleistë në vizitat e shkollave që i kam bërë dhe po them vetëm për një arsye ka qenë se sa janë të furnizuar me lëndë djegëse dhe a ka dezinfektues për shkak të covidit. Merreni me mend çfarë autoriteti ka arritë te drejtoresha, e kanë shkruar në një letër dhe nuk e di a gjendet ende në derën e shkollës fillore atje, në Mazgit, se u ndalohe të gjithëve hyrja në objektin e shkollës. Mirëpo, aty, nuk është e bazuar në asnjë urdhëresë administrative, në asnjë Udhëzim Administrativ. Prandaj, konsideroj se kjo përzgjedhje nuk është përzgjedhje e duhur. po thirrmi në profile teknike, në profile rreth KEK-ut, që të iu japim mundësi për shkak të Ligjit për Obiliqin, për shkak të rrethanave që të punësuarit në profilin e Arsimit të jenë nga Komuna e Obilqit, me ato kritere që i zgjidhni. Unë e kuptoj se mund të ketë drejtorë sepse është e pamundur mos me pasë, se ne jemi qe 8 vite këtu, kemi ndarë bursa në profile të ndryshme, i kemi ndarë në mënyra të ndryshme, kemi punuar në drejtimin që të jemi Komunë gjithëpërfshirëse. Prandaj, kërkoj që zgjedhja e drejtorëve nëpër shkolla të mos bëhet politike, por profesionale.

**Kryesuesi** – Unë e falenderoj Komisionin, i cili e ka bërë punën më të mirë të mundshme profesionale dhe e di që mediat e kanë monitorue procesin. Unë i përgëzoj drejtorët e zëvendës drejtorët dhe mendoj se Arsimi në Komunën tonë është në nivelin e kënaqshëm të mundshëm.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** — Ju njoftoj se në KPF, i kemi pasë 2 kërkesa për shqyrtim lidhur me emërimin e rrugëve dhe ne ramë dakord që në muajin e ardhshëm do ta formojmë një Komision në Kuvend për shqyrtimin e tyre.

Kërkesa tjetër në KPF, ishte me nr.-I-10869, e dt.01.06.2021 nga një qytetarë për ndihmë financiare e cila i është rekomanduar për shqyrtim Zyres së Kryetarit dhe DSHPE-së.

Tani, e kemi kërkesën nga MAPL-ja, për

shfuqizimin e vendimit nr.-I-68, të dt.30.04.2021, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-344, për vlerën e shujtës ditore për shërbyesit civil. Në Kornizën e parë buxhetore nuk është paraparë një planifikim buxhetor për shujtë, por në Kornizën e dytë nëse planifikohet ne do ta aprovojmë.

**Enver Gashi** – Ne e përkrahim këtë shfuqizim të vendimit.

**Lulzim Sadiku** – Ne nuk mund të dalim përtej ligjit dhe jam për shfuqizim sepse nuk mund ti mbrojmë shërbyesit civil, kur nuk kemi të drejtë.

**Fatos Kurshumlija** – Edhe ne jemi pro, por herë do kurdo që vjen do ta përkrahim prapë.

**Aziz Bici** – Ju e dini se herën e kaluar e kemi përkrahë unanimisht përfshirë edhe neve 2 anëtarëve të LVV-së. Mirëpo, kështu qdo muaj në vazhdimësi po vijnë vendimet për shfuqizim dhe kjo të bën vërtetë me

dyshue se Ekzekutivi nuk është në nivel sa duhet dhe dyshohet se këto më tepër bëhen për përfitime politike.

dhe kjo të bën vërtetë, me dyshue se Ekzekutivi nuk është në nivel sa duhet dhe dyshohet se këto më tepër bëhen për përfitime politike.

**Kryesuesi**– Sqaron se ne vendimin e parë e kemi marrë për shujtë dhe është pranuar ligjshmëria, pastaj është kërkuar ta zbresim nga 2 €, e 50, në 2 €, tash qeveria e re thotë se nuk ka fare për askend dhe ndërprehet me vendim të ministrit dhe Komisionit.

**Kryetari**– Sqaron se ky është vendim i juaji, e jo i Ekzekutivit dhe kësaj radhe ju si Kuvend nuk keni bërë mirë, e jo ne.

**Aziz Bici** – Këtu, u tha se nëse vjen prapë ne do ta përkrahim, por Ekzekutivi e ka Zyren për çështje ligjore e cila mund të na thotë se nuk mund ta marrim këtë vendim sepse ligji nuk lejon.

**Nora Preniqi** – Ne e përkrahim vendimin.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin për Shfuqizimin e Vendimit nr.-I-68, i dt.30.04.2021 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-344, të dt.30.11.2020, për vlerën e shujtës ditore nga 2.50 €, në 2 €, për Shërbyesit Civil të punësuar në administratën e Komunës së Obiliqit.**

**Kryesuesi**– Paraqet kërkesën nga MAPL-ja, për shfuqizim të vendimit br.-I-70, të dt.30.04.2021, për pajisje me leje ndërtimore të objekteve për ndërtim të garazhdave dhe podrumeve në lagjen Hadja e Re, në Shkabaj.

**Enver Gashi** – Ne jemi për shfuqizim të këtij vendimi.

**Lulzim Sadiku** – Unë do të votoj kundër sepse kam kërkuar që 2,3 muaj këtë temë me trajtue dhe planin urbanistik zhvillimor edhe pse e kemi paguar është vonuar, që nuk e di pse është vonuar. Unë kam biseduar me Kryetarin në mënyrën më të thukët që vërtetë, me gjetë një modul që njerëzve 200 metra afër shiritave me iu dhënë mundësia me punue. Ne nuk po e gjejmë mundësinë dhe unë do të jem kundër.

**Aziz Bici** – Ne do të votojmë kundër.

**Nora Preniqi** – Pyeti se a është në planin urbanistik vendimi për zonën kadastrale në Shkabaj.a parashihet

**Kryesuesi** – Përgjegjet po.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 9 vota për dhe 5 vota kunder e aprovuan Vendimin për Shfuqizimin e Vendimi nr. -I -70, të dt.30.04.2021 për pajisje me leje ndërtimore të objekteve për ndërtim edhe të garazhdave dhe podrumeve sepse deri më tani objektet në lagjen Hadja e Re, në fshatin Shkabaj janë pajisur me leje vetëm për etazhitetin P + K.**

**Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryetari** – Paraqet kërkesën për kufizimin e lëvizjes së automjeteve në sheshin e qytetit gjatë sezonës së verës.

**Fatos Kurshumlija** – Kryetar prej orës 5 të mëngjezit der në 8 në mbrëmja si mund të bëhet furnizimi sepse unë kam punuar dhe punoj me furnizime dhe mendoj se në ora 8 të gjithë e fillojnë punën, prandaj propozoj që të paktën me ua rritë 1 orë, ose 2 orë. Mua më duket shumë deri në orën 20, por ua kisha bërë deri në ora 18 sepse ata që furnizohen, furnizohen deri në ora 5.

**Fatmir Bekteshi** – Propozoj që për pesha të rënda psh deri në 3.5 më së shumti të mos dëmtohen kockat, por të vendosen shenjat në hyrje dhe dalje të rrugës.

**Lulzim Sadiku** – Pajtohem për peshën, por a kemi të drejtë apo, jo sinqerisht nuk e di. Unë e kam edhe njëkërkesë për këtë sezonë nëse, bën. Rruga ku përvidhet te shinat te TC Kosova B, gjatë kësaj kohe pasi që nuk qarkullojnë trenat, a kemi të drejtë ta lejmë ashtu të lejuar, sepse besoni ndihmon shumë në këtë sezonë. Unë po flas për këtë periudhën si vendim i përkohshëm që mos me pengue, por njëkohësisht me qenë e hapur sa janë mërgimtarët për 4 muaj.

**Kryetari** – Ne mund të ia bjmë një kërkesë hekurudhës dhe nëse, na e krijojnë këtë mundësi pse jo. Është mirë me bënë edhe një kërkesë me ndërtimin e ri të hekurudhës për një nënkalin, pak më këndej për me qenë

një nënkalim për me pasë mundësi me shfrytëzue edhe pjesa e mbetur andej hekurudhe

**Aziz Bici** – Prej orës 8-18, unë mendoj se është e mjaftueshme për lëvizje, ndërsa sa i përket transportit se sa është i lejuar me pesha, është dashur me kërkue nga ai që e ka bërë projektin apo nga kompania.

**Kryetari** — Sa i përket çështjes së peshës, ne i kemi 2 inxhinierë të komunikacionit që mund ti konsultojmë dhe nëse, ka nevojë me marrë edhe pëlqim nga Ministria përkatëse. Mirëpo, qëllimi është te rruga, hapjen dhe mbylljen e rrugës në këtë rast e gëzon të drejtën Kuvendi me dhënë pëlqimin se në çfarë kohe doni me qenë e hapur.

**Kryesuesi** – Pyeti rruga a do të jetë njëkahëshe, a do të ketë qarkullim edhe për autobusë sepse ngarkesa është problem. Kamioni për bartjen e mbeturinave për raste emergjente është mbi 5 ton, por edhe qarkullimi për veturat tjera, apo a është menduar për cilindra për ato biznese.

**Kryetari** – Përgjegjet po me cilinda ka me qenë dhe në kohën e caktuar ngriten dhe ulen cilindrata, do të thotë policia ka me pasë mundësinë në çdo kohë të lëvizjes nëse, ka nevojë, ndihma e shpejtë dhe zjarrfikësitnëse, ka nevojë. Çështja e rrugës ka me qenë një drejtim dhe autobusët nuk kanë vend për kalim. Sa i përket furnizimit në momentin kur bëhet një orar besoj se ata banorë do ta kuptojnë se në atë kohë nuk ka lëvizje.

**Fatmir Bekteshi** – Dua, të ndërlihem me diskutimin e z.Lulzim Sadiku për çështjen e kthesës te Kosova B, tash që e kanë mundësue me pasë qasje aty. Është shumë e rrezikshme dhe kur është hapë unë gati kam bërë aksident. E kam thirrë në telefon z.Naim, dhe e kam pyet pse e keni hapë këtu, sepse është vijë e plotë dhe nuk shehë asgjë, është kthesë e rrezikshme. Vendimi që ishte me ardhë pak më këndeje është e udhës sepse aty te Kosova B, është shumë e rrezikshme.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për e aprovuan Vendimin për Ndalimin e lëvizjes së automjeteve në rr. "Dëshmorët e kombit" për sezonin e Verës prej orës 19-05, ndërsa në sezonin e dimrit prej orës 20-05.**

**Shaip Paloja** – Te rruga Palaj në Obiliq, është një gropë te Ndërmarrja "Kimi" e hapur më tepër se 6 muaj dhe aty rrezikohet komunikacioni në çdo moment.

**Samire Berisha** – Kryetar, mirënjohjet që i keni ndarë për ditën e çlirimit të Obiliqit, çfarë kritere keni përdorë për ndarjen e atyre mirënjohjeve. Po ashtu, a i kanë plotësuar ata ato kritere që ju keni ndarë ato mirënjohje.

**Labino Mirëna** – Unë e kam një kërkesë te çështja e sheshit, rruga që qon te banesat Hade 1 dhe Hade 2, po parkohen veturat në shiritin e rrugës kryesore aty. Po ashtu, kam një vërejtje jashtëzakonisht të madhe për policinë e Kosovës në Obiliq, te banesat e Hades, parkohen te hymja dhe ajo pjesë e oborrit është e zënë. Unë iu kisha bërë ftesë me dalë dhe me mbikqyrë se tash po ka edhe vizitorë që po hyjnë në shesh dhe veturat janë në rrugë, që është një qarkullim jo i mirë dhe një situatë jo e mirë.

**Aziz Bici** - Unë e kam një pyetje lidhur me ndarjen e zonave për tatimin në pronë, do të thotë është një diferencë shumë e madhe dhe nuk e di se çfarë kritere kanë marrë për bazë. Psh qysh kam informacion për fshatrat Mazgit, Llazarevë dhe Baimoc, vlera e tatimit në pronë është caktue 250 €, ndërsa për fshatrat Sibofc, Hamidi, Milloshevë, Plemetin, Kozaricë dhe Breznicë, 180 €. Ajo që është më e çuditshme rr"Hasan Prishtina" në lagjen poshtë dhe lartë është një diferencë shumë e madhe 180 €, sa e di unë poshtë nga hekurudha dhe 250 €, është këndeje. Mendoj se është një diferencë shumë e madhe dhe pyes qysh ka mundësi të jetë kështu.

**Kryetari** – I përgjegjem z.Shaip, për rrugën se ne kemi biseduar edhe me drejtorin dhe besoj se do të trajtohet ky problem. Ne po mundohemi me ndërhye edhe me gjoba sepse te rruga nuk bëhet prerja pa e marrë mundësinë e lejes. Sa i përket ambullantës në Palaj, ne do të bisedojmë me z.Haki, dhe me znj.Vlora

me pa se a ka mundësi me funksionalizue dhe nëse, nuk ka mundësi atëherë me mund me shfrytëzu për diçka tjetër me ia ndërrue destinacionin. Unë e di se një memorandum e kemi lidhë me një organizatë për bashkëfinancim për mjekë në Milloshevë, që të bëhet në 2 ndërrime shërbimi. Mbi të gjitha, na ka bërë të ndjehemi mirë se edhe atë ditë ministri e përmendi Obiliqin, sa i përket çështjes së vaksinimit. Tek mirënjohjet ka qenë një Komision, i cili është marrë me trajtimin e tyre dhe jam munduar me i ndarë në faza, që nga faza e pasuftës së dytë botërore. Komisioni ata qëi kanë propozuar edhe janë miratuar, por kjo nuk do të thotë se nëse, dikush nuk ka marrë nuk do të merrë në festat tjera. Mbi të gjitha, unë jam mundue me i nderue pjesën më të madhe që kemi pasë njohuri dhe Drejtoria që është marrë me këtë çështje. Sa i përket parkimit të veturave, nëse nuk gaboj sot është dërgue në Prokurim dhe do të bëhet një parking te tregu që e kemi dhe te kjo pjesa që e kemi shpronësue përballë policisë. Të planifikuar e kemi pasë edhe ndërtimin e parkingut tjetër ku është objekti i vjetër, por për shkak të ngritjes së madhe të ç mimit të hekurit, po presim në të ardhmen se cila është mundësia për me zgjidhë këtë problem. Sa i përket çështjes së tatimit z.Aziz, ne nuk jemi marrë me këtë temë sepse i përcakton Ministria, por në vitin e ardhshëm kur bëhet Rregullorja për tatimin në pronë mund të dërgojmë ndonjë rekomandim.

**Nora Preniqi** – Dua, ta paraqes një shqetësim të qytetarëve për furnizim me ujë të pijes. Dua të pyes se a është në kompetencë të Komunës, ti inspektoj keqrdoruesit e ujit, apo është kompetencë e ujësjellësit.

**Kryetari** – Përgjegjet se disa fshatra po mbeten pa ujë për shkak të keqbërësve dhe ne i kemi ofrue mundësi edhe ujësjellësit sepse realisht është përgjegjësi e tyre. Nëse, ka nevojë edhe inspektorët dhe policia mund të ndërhyjnë në këtë proces sepse sidomos në këtë kohë të vapës ka mungesë të ujit.

**Lulzim Sadiku** – Unë deshta të ndërlidhem te mirënjohjet dhe unë edhe miqësisht e luta Kryetarin, që me gjetë një modul dhe me iu dhënë njerëzve që e meritojnë. Atë ditë isha në takim, dhe pashë mangësi sepse ne jemi anëtarë të Kuvendit dhe duhet ta themi edhe të mirën dhe të keqen. Unë pashë mangësi te himni, u përziën himnat sepse nuk është lehtë me dalë para masës. Po ashtu, kur iu dha mirënjohje djalit të Rugovës, nuk pati foto të Rugovës, që nuk më pëlqeu dhe nuk pati qytetar nderi në Komunën e Obiliqit sepse besoj se ka njerëz që e meritojnë. Mirëpo, unë them se gjithmonë është mirë me na ftue sepse e japim kontributin dhe mos me anashkalue kurrë Kuvendin. Mirënjohje iu dhanë njerëzve meritore, por kishte edhe nga ata edhe tupanxhi. Vërtetë, pak u preka sepse është dashur me iu dhënë mirënjohje edhe mësimdhënësve. Tani, mos me i dhënë mirënjohje Hetem Kutllovci, që besoj se Kryetar pajtohesh qind për qind me mua vërtetë, nuk është në rregull. Një njeri besnik për periudhën 90-2000, të Arsimit në Obiliq, Hetem Kutllovci, është meritore ndoshta për qytetar nderi. Kërkoj falje që e pëmendi prindin e një koleges, mos me i dhënë një mirënjohje Jahja Prestreshit, një veterani dhe ushtari besnik të Arsimit, që e ka mbajtur Arsimin prej viteve 90-2000, nuk është në rregull. Mbi të gjitha ka familje që i ka 400 vjet përvojë në Arsim, nëse e marrim nga trangu familjar, është edhe Hetem Sadiku, që është dashur me i dhënë një mirënjohje sepse ka pasë vërejtje. Këta, 3 persona qëi përmenda vërtetë kanë dhënë shumë për Arsimin në Komunën e Obiliqit, janë shtyllat kryesore dhe thelbësore, që e kanë mbajtur shtëpi për shtëpi, derë më derë për mos me u mbyllë.

**Kryetari** – Sinqerisht jemi mundue me i nderue të gjithë dhe kur kemi fillue me i numrue ishte rendi kogja shumë sepse kemi shumë njerëz të cilët jashtëzakonisht kanë kontribue në Arsim. Me lejen e Bordit që e kemi pasë, në atë kohë është marrë vendim për Arsimin meqë, viti shkollor akademik fillon në shtator me nda veç Arsimin në shtator sepse kemi mjaft njerëz meritore, që kanë dhënë shumë në Arsim. Është planifikuar të gjithë mësimdhënësit të cilët janë pensionuar për periudhën e pasluftës me iu dhënë nga një mirënjohje dhe me qenë një ditë e veçantë vetëm për ata. Ky organizim ka qenë planifikuar me 7 mars, të ndodhë, por për shkak të pandemisë nuk kemi mund ta bëjmë. Besoj se në shtator të gjithë bashkarisht do të ulemi me i shqyrtue ata që janë të pensionuar të gjithë drejtorë, mësimdhënës, qoftë edhe punëtorë të shkollave me iu dhënë mirënjohje. Këru, nuk ka pasë ndonjë tendencë, por ishte numri aq i madh sa që i humbte kuptimi dhe kemi menduar 1 shtatori të jetë një organizim i ri për të gjithë të tjerët, që meritojnë.

**Fatos Kurshumlija** – Kryetari e përmendi më heret se qytetarët po kanë telashe në kyqje të ujësjellësit, ose të kanalizimit. Unë kam biseduar më heret me Kryetarin për rrugën Lajthishtë, që ka me u renovue tash

shumë shpejtë, a ka ndonjë marrëveshje, apo memorandum me ujësjellësin për 2 tuba të ujit prej shkollës deri te xhamia sepse aty prapë do të renovohet rruga dhe aty çdoherë ka rrëshqitje të tokës. Për momentin llogarite është vetëm një tubë në mes të rrugës dhe të gjithë kanë kyqje në të dhe një prishje duhet me pre tërë rrugën për atë dhe rruga aty është bërë pjesë, pjesë.

**Kryetari** – Përgjegjet se kur i bëjmë projektet infrastrukturën nëntokësore po mundohemi me llogaritë se kujt i takon dhe nëse, ka të bëjë me ujësjellësin patjetër se ka me pasë bashkëpunim. Shpeshherë ata e kanë sjellë gypin, ne e kemi bërë kanalin dhe ai bashkëpunim ekziston, por a e kanë në projekt nuk e di.

**Fatos Kurshumlija** – Është hera e katërt që drejtori i infrastrukturës asnjëherë nuk merrë pjesë në mbledhje.

**Kryetari** – Ke të drejtë, por sinqerisht tash infrastruktura dhe administrata ka shumë punë dhe po mundohemi me i shpërndarë, sidomos tash ky fluksi i mërgimtarëve që ka ardhë po mundohemi me qenë sa më afër tyre. Jemi duke e pa mundësinë e rritjes së orarit të punës të regjistrimit civil, pas orarit të punës për mërgimtarët. Ndërsa, zyrtarët e inspeksionit dhe drejtori i infrastrukturës, tash të gjithë janë në terren sepse kanë shumë aktivitet.

**Shaip Paloja**– Unë pajtohem se aty ku punohet bëhen edhe lëshime, sa i përket Arsimit, mirënjohjet që iu janë dhënë atyre njerëzve, mendoj se janë shumë meritore. Kërkoj nga z.Lulzim Sadiku, ta tërheqë fjalën dhe të kërkoj falje për tupanxhitë sepse ata njerëz nuk janë tupanxhi, por janë njerëz që kanë kontribue prej viteve të 90-ta, në folklore dhe në

ç do aspekt tjetër. Ndoshta, z.Lulzim në atë kohë ka dëgjue në veturë, ose në ara dikund muzikë, prandaj kërkoj që të kërkoj falje dhe ta tërheqë fjalën.


**Lulzim Sadiku** – Unë kam thënë që për Ansamblin, për atë kategori të gjenden forma që të paguhen edhe ata. Unë nuk kërkoj falje për një diçka që nuk e bëjë të barabartë një të ri që merret me muzikë në këtë kohë, me atë që ka punue dhe është maltretue 10 vjet. Nga ata që unë thashë tupanxhitë është numër i vogël i Ansamblit, që i përdora dhe aty sikur të ishte dhënë një mirënjohje vërtetë, isha pajtue. Unë Kryetarit i thashë në mënyrën më miqësore se vërejtje ka pasë aty, dhe ndoshta me shikue gjendjen reale të familjeve të dëshmorëve, sa herë që po u japim është rutinë. Aty, ka pasë vërejtje sepse ne jemi për atë që të gjitha familjet e dëshmorëve ti privilegjojmë, por edhe Kryetari e pa se ky numër është i madh. Unë sa e kam qëllimin e mirë e dijnë edhe ata tupanxhitë, por i mora si shembull. Kryetari i dha mirënjohjet një nga një, dhe pata vërejtje sepse unë kisha dëshirë edhe dikush me i dhënë, por po shkojnë gjërat pa i analizue mi ë. Pra, Komisioni tjera herë është mirë me qenë pjesë e përbashkët, me i dhënë mirënjohje edhe një komandanti, edhe një intelektual, por e thashë se edhe Kryetarit, iu bë rutinë iu bë shumë.

**Kryesuesi** – Ju falenderoj për kontributin dhe angazhimin tuaj dhe uroj që zgjedhjet ti kalojmë në mënyrë të qetë ashtu si i ka hije Obiliqit.

**Mbledhja përfundoi në ora 13:00**

**Bashk.prof.për punë të KK**

**Azize Zeneli**



**Kryesuesi i Kuvendit komunal**

**Burim Gërguri**